



Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, të nenit 3, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, dhe të nenit 4, paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr. 23/2010, për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit – Komuna e Prishtinës, në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për – **familjet me gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike**, me ndihmën e Programit të veçantë të banimit, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, jep banesa me qira joprofitabile për periudhën kohore të caktuar sipas marrëveshjes dhe bën shpalljen publike të

K O N K U R S I T

Komuna ka siguruar Program të veçantë të banimit për **familjet me gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike**, që nuk e kanë zgjidhur çështjen e banimit, duke ndarë banesa me qira joprofitabile për të krijuar kushte të përshtatshme për banim normal.

• **Kanë të drejtë të jenë përfitues të këtij programi familjet që:**

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
2. Kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë;
3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

• **Përcaktimi i personave/familjeve përfituese bëhet mbi bazën e kriterëve të përparësisë, si vijon:**

- a. Statusi i banimit;
- b. Lartësia e të ardhurave;
- c. Gjendja shëndetësore;
- d. Invaliditeti i pjesëtarëve të familjes dhe
- e. Struktura familjare.

• **K r i t e r e t s h t e s ë j a n ë:**

- Familja e kryesuar nga një prind/prindi vetushqyes dhe
- Familja që ka në mbikëqyrje/përkujdesje fëmijët jetimë.

• Familjet që bëjnë kërkesë për të përfituar nga ky program i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të komunës së Prishtinës.

• Për zgjedhjen e përfituesve nga programi i veçantë i banimit, përparësi kanë familjet me numër më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të “Udhëzimit administrativ

nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit”.

- Në rast se aplikuesit pas vlerësimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve, atëherë përparësi do të kenë familjet me më shumë anëtarë” (*sipas nenit 5, paragrafi 4, të Udhëzimit administrativ nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit*).
- Komuna si investitor, ka në dispozicion për këtë program të veçantë të banimit objektin banesor të ndërtuar në fshatin Hajvali, me **50 (pesëdhjetë) njësi/banesa**, të cilat i jep me qira joprofitabile për kategoritë me gjendje të rëndë sociale ekonomike dhe të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.
- Organi komunal kompetent bën shpërndarjen e aplikacioneve pa pagesë, **në formë standarde**, për të gjithë aplikuesit e interesuar, ndërkaq të gjithë aplikuesit të njëjtat mund t`i marrin në Zyrën/sportelin nr. 3, në ndërtesën e (vjetër) të Komunës së Prishtinës, rruga “UÇK-së” nr.2, kati përdhes, çdo ditë pune prej **orës 8:30 deri në orën 15:00**.
- Kërkesa e plotësuar dhe dokumentacioni i nevojshëm dorëzohen dhe pranohen në komunë çdo ditë pune.
- Konkursi mbetet i hapur **30 (tridhjetë) ditë** nga dita e shpalljes publike në njërin nga gazetat e përditshme, duke filluar prej dt. 01.11.2016 deri me dt. 12.12.2016 ,ndërsa raporti dhe dokumentacioni i kompletuar i përcillet komisionit vlerësues brenda 5 (pesë) ditësh.
- Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e familjeve bën shqyrtimin e gjendjes së banimit dhe të dhënave të tjera të nevojshme të aplikuesve, brenda **30 (tridhjetë) ditëve, ndërkaq brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasuese do të bëjë vlerësimin dhe verifikimin në terren të parashtruesit të kërkesës**.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit kohor, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen të pavlefshme.
- Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për t`u kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të banimit social.
- Ndalohet bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.
- Komuna në tabelën e shpalljeve do të publikojë listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
- Kohëzgjatja e përfitimit nga programi i veçantë për banim 3 (tre) vite.
- Pas shpalljes së listës, familjeve të renditura sipas pikëve të fituara dhe kundër Vendimit të Komisionit vlerësues, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë me shkrim brenda **30 (tridhjetë) ditëve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - MMPH**, nga dita e pranimit të Vendimit.

❖ Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrin e telefonit: 038/230-900 - lokali:1050.